

Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Programi ndërkombëtar i luftës kundër terrorizmit/ <i>INT'L CNTRTERRORISM FELLOWS PRGM (NDU)</i> (Master Artesh ne Studime Strategjike te Sigurise)
2	Kriteret e kërkuara të specialitetit	Grada: N/Kolonel - Kolonel qe punojnë ne fusha/disiplinat e luftës kundër terrorizmit.
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës / gjuhëve	Anglisht 90 pikë ALCPT/ECL
4	Përshkrimi	Ky kurs i siguron pjesëmarrësve një mundësi studimi dhe pune kërkimore në fushën e luftës kundër terrorizmit. Menjëherë pasi pjesëmarrësit mbërrijnë, ata bëhen pjesë e një programi familjarizues 6-javor, me qëllim përshtatjen e tyre me mënyrën e jetesës në Washington D.C. dhe përgatitjen për vitin akademik. Programi familjarizues/orientues konsiston në prezantime të ndryshme, orë akademike mësimore, trajnim në përdorimin e kompjuterit, aktivitete kulturore dhe njohja me qytetin. Programi akademik ndahet ne disa faza qe përfshijnë studime te te mendimit te strategjisë kombëtare, doktrine dhe operacione te përbashkëta, çështje te sigurisë ndërkombëtare, lufta jo konvencionale, kundër-terrorizmi. Programi përmbyllet me teme masteri sipas interesit te kandidatit ne fushën e sigurisë kombëtare dhe luftës kundër terrorizmit.
5	Periudha e zhvillimit të kursit	Periudha e pacaktuar (zgjat 1 vit)
6	Vendi i zhvillimit të kursit	Washington D.C., SHBA
7	Afati i dërgimit te kandidateve	01.11.2021
8	Kuota	1 (një)
9	Tjera	Kandidatët duhet të kenë eksperiencë në luftën kundër terrorizmit. Kandidatët e miratuar të sigurojnë një kopje të listës së notave (të Akademisë Ushtarake), si dhe një kopje të kurrikulës mësimore të zhvilluar në Akademinë Ushtarake, të përkthyer në gjuhën angleze.

